



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.719/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada - Gllogjani dhe Kymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Agnesa Jetishi, kandidate për kuvend komunal nga Subjekti politik Nisma Socialdemokrate në Komunën e Ferizajt, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me objekt të çështjes manipulim i votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 27.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa Anr.719/2021 e datës 27.10.2021, e paraqitur nga Agnesa Jetishi, kandidate për kuvend komunal nga Subjekti politik Nisma Socialdemokrate në Komunën e Ferizajt, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me objekt të çështjes manipulim i votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 27.10.2021, ka pranuar një ankesë Anr.719/2021 nga Agnesa Jetishi, kandidate për kuvend komunal nga Subjekti politik Nisma Socialdemokrate në Komunën e Ferizajt, më të cilën theksohet se në vendvotimin 2506D/04D, partia Nisma për kuvend komunal ka 7 vota kurse shuma e mbledhur e votave për kandidat është 6. Tek numri 21 i nismës në FPR është shkruar numri 0 vota, mirëpo pasi është shkruar 1 është përmirësuar me numrin 0, mbi çka dyshon se votat i janë humbur dhe manipuluar.

Më tutje pretendon se Subjektit Nisma Socialdemokrate në Ferizaj nuk i janë lejuar numër i kërkuar i komisionerëve nëpër vendvotime pasi që ky subjekt nuk ka akredituar asnjë nga vëzhguesit që i ka propozuar, andaj sipas të njëjtës pretendon se kjo lë hapësirë për mundësi dhe manipulim, ku votat e shumë kandidateve janë ndryshuar duke u vendosur tek kandidatët e dëshiruar nga bartësit e partisë, kandidatë këta të cilët “rastësisë” të jenë familjarë të Kryetarit të Partisë Nisma Socialdemokrate në Ferizaj dhe anëtar të kryesisë së kësaj partie.

Kandidateve të cilat u janë shtuar votat brenda partisë Nisma duke manipuluar në numërim dhe përshkrim të votave janë: Arbenita Berisha me nr. 9 (familjare e kryetarit të partisë), Tringa Berisha me nr. 12 (familjare e kryetarit të partisë), Frosina Berisha – Ahmeti me nr. 17 (vajza e kryetarit të partisë) dhe Ismete Berisha me nr. 20 (familjare e kryetarit të partisë).

Parashtruesja e ankesës ka kërkuar që vendvotimet 2501D-06R, 2501Y-08R, 2501Y-12R-2503D-04R, 2503D-04R, 2503D-05D, 2508D-03D, 2517D-01R, 257D-02D, 2522D-01R, 2525D-03D, 2531D-01R, 2532D-02D, 2534D-01R dhe 2540D-01D të shkojnë në rinumërim pasi që dyshon se në këto vendvotime ka pasur parregullsi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkritazi me parregullsitë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankueses. Hudhja e ankesës së Agnesa Jetishi, kandidate për kuvend komunal nga Subjekti politik Nisma Socialdemokrate në Komunën e Ferizajt nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.719/2021 më datën 27.10.2021

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*

